



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 shtator 2015
Nr. ref.:837/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI75/15

Parashtrues

Hatixhe Cana-Kurti

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0218-A0001-A0004, të 14 majit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Hatixhe Cana-Kurti me vendbanim në fshatin Livoç i Ulët, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-14-0218-A0001-A0004] të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave), të 14 majit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-14-0218-A0001-A0004] të Kolegjit të Ankesave, të 14 majit 2015, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Në të njëjtën kohë, parashtruesja e kërkesës kërkoi që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, me të cilën do të ndalonte shpërndarjen e mëtejshme të 20%-shit të të ardhurave nga shitja të gjithë punëtorëve që kanë realizuar të drejtën e tyre në këto të ardhura nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore Agrokultura (në tekstin e mëtejme: NSH Agrokultura) derisa Gjykata të vendosë për meritat e kërkesës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 qershor 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI75/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI75/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 1 korrik 2015, Gjykata e informoi parashtruesen e kërkesës dhe Kolegjin e Ankesave për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 21 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja e kërkesës ishte e punësuar në Ndërmarrjen Shoqërore (në tekstin e mëtejme: NSH) Agrokultura nga 15 maji 1985 e deri më 31 mars 1995.

11. Më 26 mars 2006, NSH Agrokultura ishte privatizuar.
12. Më 10 dhjetor 2010, Agjencia Kosovare për Privatizim (në tekstin e mëtejme: AKP) publikoi listën përfundimtare të punëtorëve që kishin realizuar të drejtën në pjesën e 20%-shit të të ardhurave nga privatizimi i NSH Agrokultura, në të cilën nuk gjendej parashtruesja e kërkesës. Në arsyetimin e vendimit theksohet *„se të gjithë parashtruesit tjerë që nuk janë të kënaqur me vendimin e Agjencisë për Privatizim kanë të drejtë ankese në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) deri më 31 dhjetor 2010“*.
13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare e cila ishte publikuar më 10 dhjetor 2010 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Në ankesë, parashtruesja, përveç pretendimeve *“se në vitin 1995, për shkak të diskriminimit të regjimit të atëhershëm dhe menaxhmentit të ndërmarrjes marrëdhënia e saj e punës ishte ndërprerë”* parashtrroi një vërtetim të lëshuar nga drejtori i ndërmarrjes si dëshmi për statusin e saj të mëparshëm të punësimit, të cilin ajo e ka pasur gjatë periudhës prej 15 majit 1985 e deri më 31 mars 1995.
14. Më 10 korrik 2014, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) nxori Aktgjykimin e tij [SCEL- 10-0038] me të cilin aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe urdhëroi Dhomën e Posaçme ta përfshijë në listën përfundimtare me punëtorët e tjerë të cilët kishin fituar të drejtën legjitime në një pjesë të 20%-shit të të ardhurave nga privatizimi i NSH Agrokultura.
15. Në një datë të pacaktuar, AKP-ja parashtrroi ankesë kundër këtij aktgjykimi [SCEL- 10-0038] të Kolegjit të Specializuar, sepse AKP-ja nuk kishte mundësi të përgjigjej ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në Kolegjin e Specializuar.
16. Në ankesën e saj, Agjencia Kosovare e Privatizimit theksoi: *“Ankuesja (parashtruesja e kërkesës) nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të të cilave kishte për të vërtetuar faktin se nuk ishin të barabartë dhe arsyetimin për aplikimin e diskriminimit direkt apo indirekt në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit. Ankuesja nuk ka ofruar fakte për diskriminim, dhe e paditura (Agjencia për Privatizim) nuk ka mundur të paraqes kundër argumentet e saja lidhur me diskriminimin, në të cilat ankuesja [parashtruesja e kërkesës] e ka bazuar ankesën e saj”*.
17. Më 14 maj 2015, Kolegji i Ankesave, pas shqyrtimit dhe pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve dhe të dëshmimeve në shkresat e lëndës, të cilat i kanë dorëzuar palët në procedurë, konstatoi se ankesa e Agjencisë për Privatizim ishte e bazuar dhe, me Aktgjykimin [AC-I-14-0218-A0001-A0004], ndryshoi Aktgjykimin [SCEL- 10-0038] e Kolegjit të Specializuar dhe refuzoi kërkesën e parashtrueses si të pabazuar.
18. Në arsyetimin e Aktgjykimit [AC-I-14-0218-A0001-A0004], Kolegji i Ankesave theksoi: *“Paditësja -C-0002-Hatixhe Cana e kishte librezën e punës të mbyllur*

me 1995, nuk ka ndonjë vendim për punësimin e saj para kësaj periudhe, nuk ka vendim për pushim nga puna dhe nuk ka ofruar dëshmi tjera për të dëshmuar se ka punuar deri në privatizimin e NSH-së, apo të ketë qenë në listën e pritjes, siç ka deklaruar në ankesë në Dhomën e Posaçme. Për këto arsye, ankuesja nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/13, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, për të hyrë në listën përfundimtare, për të drejtën legjitime për 20%”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesja e kërkesës konsideron se Kolegji i Ankesave, me aktgjykimin e tij, ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, në raport me palët e tjera.
20. Parashtruesja i drejtohet Gjykatës me kërkesë: „Dëshiroj të më njihet e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për marrjen e 20 % nga të hyrat e privatizimit të NSH ”Agrokultura” Gjilan.“

Pranueshmëria e kërkesës

21. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës, parasheh:
“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
23. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit, gjithashtu parasheh:
“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
24. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.*
25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [AC-I-14-0218-A0001-A0004] e Kolegjit të Ankesave, me të cilin pretendohet se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

26. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka shpjeguar se si dhe pse Aktgjykimi [AC-I-14-0218-A0001-A0004] i Kolegjit të Ankesave ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë.
27. Gjykata, në bazë të kërkesës së parashtrueses, vërejtë se parashtruesja është përpjekur ta arsyetojë shkeljen e pretenduar të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës ekskluzivisht me deklaratën: „[...] *Konsideroj se Kolegji i Ankesave me Aktgjykimin e tij kishte shkelur parimin e barazisë para ligjit në raport me palët tjera.*“
28. Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave kishte bazuar vendimin e tij në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13, MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE, të 9 majit 2003, i cili *inter alia* parasheh:
- „Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6“.*
29. Për më tepër, Gjykata vëren se, në bazë të këtij ligji, Kolegji i Ankesave konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë i punësuar në NSH Agrokultura gjatë periudhës së kërkuar kohore për të pasur të drejtë të përfitojë nga pjesa e 20%-shit të të ardhurave (shih par. 16).
30. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)
31. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e dispozitave të nenit 24 të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
32. Për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave kishte nxjerrë Aktgjykimin e tij [AC-I-14-0218-A0001-A0004] të 14 majit 2015, vetëm pas shqyrtimit dhe pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve dhe provave në shkresat e lëndës, të dorëzuara nga të dyja palët në procedurën ankimore.
33. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se shpjegimi i dhënë nga Kolegji i Ankesave në Aktgjykimin [AC-I-14-0218-A0001-A0004] është i qartë dhe ligjërish i argumentuar dhe se procedura në Kolegjin e Ankesave nuk ka qenë e padrejtë

dhe arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendim i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

34. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi për të dëshmuar pretendimet e saj se vendimi i kontestuar në ndonjë mënyrë shkel të drejtat dhe liritë e saj, të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës.
35. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar pretendimin e saj dhe kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

36. Siç thuhet në paragrafin 4, parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, me të cilën do të ndalohej shpërndarja e mëtejshme e 20%-shit të të ardhurave për të gjithë punëtorët që kishin fituar këtë të drejtë nga privatizimi i NSH Agrokultura, derisa Gjykata të vendosë për meritat e kësaj kërkesë.
37. Në mënyrë që Gjykata të shqiptojë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4 dhe 5) të Rregullores së punës, ajo duhet të konstatojë nëse:

“(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të riparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe

(...)

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.”

38. Siç u theksua më lart, kërkesa e parashtrueses është e papranueshme, prandaj kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (2) (b) dhe 55 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Ajta Rama-Hajrizi